

Fitimi i shtetësisë me natyralizim

Fitimi i shtetësisë me natyralizim bëhet kur i huaji plotëson kushtet e përcaktuara nga ligji për shtetësinë shqiptare:

1. Të ketë mbushur moshën 18 vjeç;
2. Të ketë banuar ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të vazhdueshme, për jo më pak se 5 vjet;
3. Të ketë banesë dhe të disponojë të ardhura të mjaftueshme;
4. Të mos ketë qenë ndonjëherë i dënuar (në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë vend tjetër) për vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënime me jo më pak se 3 vjet heqje lirie. Përgjashtime nga ky rregull bëhen në rastet kur vlerësohet se dënimi është dhënë për motive politike.
5. Të ketë njohuri të paktën fillestare të gjuhës shqipe;
6. Me marrjen e shtetësisë të mos preket siguria dhe mbrojtja e Republikës së Shqipërisë.

Shënim: Republika e Shqipërisë lejon dyshtetësinë, pra për të fituar shtetësinë shqiptare të huajt nuk janë të detyruar të lënë shtetësinë/shtetësitë e vendeve nga vijnë.

Dokumentet e nevojshme për fitimin e shtetësisë me natyralizim:

1. Kërkesa e shtetësisë të huaj drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Kjo kërkesë duhet të përmbajë identitetin e plotë të kërkuarit (emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje, shtetësi), adresën e saktë të vendbanimit të tij të përhershëm dhe adresën ku pret informim për ecurinë e aplikimit të tij si dhe arsyet e kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare. Kërkesa nënshkruhet me emër, mbiemër e firmë nga kërkuari;
2. Mendimi me shkrim i nëpunësit që pranon dokumentet për nivelin e njohurive të gjuhës shqipe;
3. Certifikata e lindjes, origjinale dhe e legalizuar në ambasadë;
4. Leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë sipas kriterëve të ligjit për shtetësinë (fotokopje e noteruar), nëse banon në Shqipëri;
5. Akti i pronësisë së banesës ose kontrata e zënies me qira të banesës (fotokopje e noteruar);
6. Kontrata e punës për të punësuarit ose vërtetimi nga zyra e tatimeve për të vetpunësuarit ose investitorët (fotokopje e noteruar);
7. Dokumente që vërtetojnë disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si garanci bankare, librezë kursimi, vërtetime zyrtare të ardhurash (fotokopje e noteruar);
8. Dëshmia e penalitetit të marrë në vendin e origjinës dhe në vendin ku kërkuari ka pasur qëndrim legal për gjashtë muajt e fundit;
9. Dokumenti që vërteton qenien azilant, nëse është i tillë (fotokopje e noteruar);
10. Mendimi me shkrim i komisarit të policisë vendore për sjelljen dhe qëndrimin e kërkuarit, nëse banon në Republikën e Shqipërisë;
11. Fotografia e aplikuesit, tre copë (në rast se ka fëmijë të mitur, fotografi për secilin prej tyre);
12. Certifikata (kur është e nevojshme) për të vërtetuar origjinën shqiptare të kërkuarit, deri në dy shkallë, qoftë dhe nga njëri prind.

Tarifa për veprimet me shtetësinë nëpërmjet ambasadës

Për shërbimet që do të kryhen, aplikuesi bën paraprakisht pagesën prej 30€ në llogarinë e ambasadës për shërbimet konsullorë dhe e dorëzon dëshminë e pagesës së bashku me dokumentet e tjerë. Pagesa është e pakthyeshme.